



## Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

*Qeveria - Vlada - Government*

---

### **Plani i Zbatimit të Marrëveshjeve të Uashingtonit**

#### **Normalizimin Ekonomik ndërmjet Kosovës dhe Serbisë**

Marrëveshja për normalizimin ekonomik (Marrëveshjet e Uashingtonit), e arritur me 4 shtator 2020, nga Kosova dhe Serbia, përfshinë obligime të cilat për nga përgjegjësia institucionale përfshinë disa institucione.

Duke u bazuar në udhëzimet e Kryeministrit të Qeverisë së Kosovës, Zyra për Planifikim Strategjik në bashkëpunim me ministrinë e linjës, ka identifikuar dhe listuar veprimet kryesore dhe institucionet përgjegjëse për zbatimin e pikave të marrëveshjes.

Duke qenë se për shumicën e pikave ka pasur zhvillimeve të mëhershme qoftë në kuadër të Dialogut të lehtësuar nga Bashkimi Evropian apo edhe disa projekte infrastrukturore kanë qenë pjesë e planeve të Qeverisë së Kosovës, për secilën pikë është bërë një përshkrim i shkurtër i gjendjes aktuale. Kjo qasje do të shërbejë për të informuar partnerët për progresin e arritur dhe për të koordinuar përpjekjet e institucioneve për zbatimin e marrëveshjes.. Përshkrimi i shkurtër i të gjitha pikave është pasuar nga veprimet konkrete për zbatimin e pikave të Marrëveshjes ku janë listuar edhe institucionet përgjegjëse për secilin veprim.

Tani pritet nga dikasteret që janë nën përgjegjësinë tuaj të merren të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e këtyre aktiviteteve apo veprimeve të dhëna në këtë dokument. Janë disa aktivitete ku përgjegjësia bie në më shumë se një institucion dhe për qëllime të lehtësimit të koordinimit dhe zbatimit të këtyre aktiviteteve kërkohet përkushtim dhe vëmendje e fokusuar edhe nga niveli politik. Koordinimi i zbatimit për të gjitha aktivitetet e listuar në këtë dokument lidhur me Marrëveshjen e Uashingtonit duhet të bëhet në bashkëpunim të ngushtë me Zyrën për Planifikim Strategjik.

**PLANI PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJES SË UASHINGTONIT**

NR.	PIKA E MARRËVESHJES	GJENDJA AKTUALE	VEPRIMET PASUESE	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS
1	<i>Të dy palët do të zbatojnë marrëveshjen për autostradën Prishtinë – Beograd të nënshkruar më 14 shkurt, 2020.</i>	<p>Autostrada Durrës-Morinë-Prishtinë-Merdare-Nish është pjesë e rrjetit Bazik të Transportit në kuadër të Rrjetit Trans-Evropian të Transportit. Segmenti nga Morina në Prishtinë është përfunduar në vitin 2012.</p> <p>Kostoja është 230 milionë euro dhe ka zotime për financim nga EIB dhe EBRD dhe gjithashtu Korporatën Ndërkombëtare për Financim të SHBA-ve (DFC). Në WBIF është aplikuar në rundin 5 të granteve investuese me kërkesën për grant investues për seksionin Besi - Merdare në shumën prej 38 milionë euro. Aplikimi për grant është miratuar në parim, ndërsa aprovimi përfundimtar pritet të konfirmohet. Ky projekt është përfshirë gjithashtu në Planin e Investimeve të BE-së për Ballkanin Perëndimor.</p> <p>Për segmentin e mbetur të Autostradës Besi–Merdare, në gjatësi prej 28 km dhe shpejtësi projektuese prej 120 km/h, në bashkëpunim me WBIF kanë përfunduar:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Plotësimi i Studimit të Fizibilitetit dhe ndikimit Social dhe mjedisor.</li> <li>• Projekti Preleminar Besi-Merdare</li> </ul>	Përgatitja dhe miratimi i marrëveshjeve të nevojshme financiare për implementimin e këtij projekti, në bashkëpunim me Institucionet Financiare Ndërkombëtare që është në përputhje me standardet e rrugëve motorike Trans-Evropiane (TEM)	Ministria e Infrastrukturës
2	<i>Të dy palët do të zbatojnë marrëveshjen e hekurudhave Prishtinë – Beograd të nënshkruar më 14 shkurt 2020.</i>	Linja hekurudhore midis Prishtinës dhe Merdares është jashtë operimit për shkak të dëmtimeve.	<p>Zbatimi i marrëveshjes hyn në kuadër të diskutimeve për financimin e projekteve që janë pjesë e Marrëveshjes së 4 shtatorit dhe pritet që të bëhet:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Formimi i grupit teknik punues.</li> <li>2. Hartimi i studimi të fizibilitetit për rehabilitimin e trasesë ekzistuese dhe trasesë së re të linjës hekurudhore Fushë Kosovë – Merdare në kuadër të standardeve teknike evropiane të ndërveprimit (TSI).</li> </ol>	Ministria e Infrastrukturës
3	<i>Kosova [Prishtina] dhe Serbia [Beogradi] do të punojnë me SHBA-të me Korporatën Financiare për</i>	Autostradën e Paqes nga pika 2 e marrëveshjes. Linja hekurudhore midis Prishtinës dhe Merdares është jashtë operimit për shkak të dëmtimeve.	Në takimet me Korporatën Ndërkombëtare të Financave dhe Zhvillimit në SHBA (DFC), USAID dhe EXIM, projektet të cilat	Institucion përgjegjës është Ministria e Infrastrukturës, e përfaqësuar nga

	<p><i>Zhvillim Ndërkombëtar dhe EXIM në memorandume të mirëkuptimit për të operacionalizuar, si në vijim:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Autostradën e Paqes,</li> <li>2. Lidhjen hekurudhore midis Prishtinës dhe Merdares;</li> <li>3. Lidhjen hekurudhore midis Prishtinës dhe Nishit;</li> <li>4. Sigurimi i financimit për të mbështetur kreditë e kërkuara për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme;</li> <li>5. Projekte bilaterale shtesë;</li> <li>6. Një prani ndërkombëtare e Korporatës Financiare për Zhvillim Ndërkombëtar me kohë të plotë në Serbi.</li> </ol>	<p>Qeveria e Kosovës do të sigurojë fonde për FKGGK që do të përdoren për të mbështetur garancitë e huasë për të forcuar aksesin në financa për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, e cila parashikohet nga Vendimi i Qeverisë 01/23 i 13.08.2020.</p>	<p>janë paraqitur, në takime të ndara për financim janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Autostrada Besi – Merdare</li> <li>• Hekurudha Prishtinë – Merdare</li> <li>• Hekurudha Prishtinë – Porti i thelle në Adriatik</li> </ul> <p>Të gjitha këto projekte do të zhvillohen tutje gjatë takimeve të ardhshme që pritet të ndodhin gjatë muajve në vijim.</p>	<p>Ministri z. Arban Abrashi Zyra e Kryeministrit, Ministria e Financave; Ministria e Ekonomisë dhe Mjedisit Ministria e Tregtisë dhe Industrisë</p>
4	<p><i>Të dy palët do të hapin dhe do të operacionalizojnë Pikën e Përbashkët Kufitare në Merdare.</i></p>	<p>Punimet për ndërtimin e Pikës së Kontrollit Kufitar (PKK) në Merdare janë të përfunduara rreth 90%. Si rrjedhojë e mosbashkëpunimit nga pala Serbe, më specifikisht refuzimit të zhvendosjes së stafit kufitar në objektin e ri të administratës, mbulesa dhe rruga në pjesën ku gjendet pala serbe tani, nuk ka mundur të përfundohet.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të alokohen burime të mjaftueshme buxhetore për mirëmbajtjen e pikës kufitare në Merdare.</li> <li>• Të zhvendoset stafi i autoriteteve kufitare në objektin e ri të administratës</li> <li>• Të fillohen mbajtjet e takimeve të rregullta të nivelit lokal, rajonal dhe qendror të autoriteteve të Menaxhimit të Integruar të Kufirit, ashtu siç parashihet me marrëveshjet e Brukselit.</li> </ul>	<p>Ministria e Punëve të Brendshme</p>
5	<p><i>Të dy palët do të futen në “mini-Schengen”, të shpалosur nga Serbia, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut në tetor të vitit 2019 dhe të shfrytëzojnë plotësisht përfitimet e saj.</i></p>	<p>Shqipëria, Serbia dhe Maqedonia e Veriut, në tetor të vitit 2019 kanë iniciuar marrëveshjen e mini-Schengenit, e cila ngërthen katër liritë e Bashkimit Evropian: lirinë e lëvizjes së njerëzve, të mallrave, shërbimeve dhe kapitaleve. Për shkak të rrethanave politike dhe diplomatike, Kosova nuk është përfshirë në marrëveshjen e Mini-schengenit.</p>	<p>Kryeministri shpreh angazhimin që Kosova do të marrë pjesë në aktivitetet e procesit, duke përfshirë takimin e ardhshëm të Liderëve si një anëtar i barabartë.</p>	<p>Zyra e Kryeministrit dhe Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës</p>
6	<p><i>Të dy palët do të njohin reciprokisht diplomat dhe certifikatat profesionale.</i></p>	<p>Deri më tani janë arritur dy marrëveshje: 1) Marrëveshja e parë për diplomat, e arritur në vitin 2011; 2) Marrëveshja e dytë për diplomat, e arritur në vitin 2016. Me financimin e BE-se është kontraktuar OJQ holandeze</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Si hap i parë do të organizohet një takim zyrtar në mes të Ministrave të Arsimit – Kosove – Serbi. Në këtë takim do të diskutohet për mënyrën e zbatimit të</li> </ul>	<p>Ministria e Arsimit dhe Shkencës</p>

		<p>SPARK që t'i menaxhojë aspektet teknike të procesit të njohjes së diplomave, ndërsa Asociacioni i Universiteteve Evropiane (EUA) është përfshirë në cilësinë e autoritetit për certifikimin e diplomave (per ata qe kane certifikatën nga EUA diploma e tyre është konsideruar valide). Në këtë fazë nuk janë përfshirë edhe diplomat e doktoratës, edhe pse marrëveshja nuk i përjashton ato. Marrëveshja e vitit 2016 ende nuk është jetësuar, edhe pse palët i kanë bërë disa veprime përgatitore në këtë drejtim. Në listën e institucioneve të akredituara të AL që edhe ka shkaktuar problemin e parë në zbatim, pala serbe e ka përfshirë edhe Universitetin e Mitrovicës së Veriut me emërtimin “Universiteti i Prishtinës me seli të përkohshme në Mitrovicën e Kosovës”, duke insistuar se ky është institucion i akredituar nga autoritetet e Republikës së Serbisë; ndërkaq pala kosovare ka refuzuar t'i njohë diplomat e këtij institucione përmes kësaj marrëveshjeje.</p>	<p>marrëveshjes për njohje/barasvlerë të diplomave.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Si hap i dytë do të takohen Qendra NARIC Kosova dhe NARIC Serbia, ku do të akordohen për çështjet administrative lidhur me procedurat për njohje/Barasvlerë</li> </ul>	
7	<p><i>Të dy palët do të bien dakord të punojnë me Departamentin e Energjisë në SHBA dhe njësi të tjera të Qeverisë së SHBA-ve në një studim të fizibilitetit për qëllimet e shfrytëzimit të përbashkët të Liqenit së Gazivodës/Ujmanit, si burim i mundshëm i ujit dhe energjisë.</i></p>	<p>Kjo ndërmarrje që nga pas lufta është transformuar në Ndërmarrje Publike N.H. „Ibër-Lepenc” nga UNMIK-u. Pas Korporatizimit të Ndërmarrjes, më 01/01/2008, Ndërmarrja është shndërruar në Ndërmarrje Hidro-Ekonomike “Ibër-Lepenc” Sh.a. Ndërmarrja është Shoqëri Aksionare në pronësi 100% të Qeverisë së Kosovës. Sektori i Ujitjes e shfrytëzon ujin nga sistemi Ibër-Lepenc për të ujitë rreth 8500 ha tokë gjatë sezonit të ujitjes, apo sasi të ujit(Q=3730 l/s). TC Kosova A furnizohet me ujë të papërpunuar nga Lumi Llap, dhe sipas nevojës edhe nga Hidrosistemi Ibër-Lepenc dhe Liqeni i Batllavës, ndërsa TC Kosova B furnizohet me ujë të papërpunuar nga Hidrosistemi Ibër-Lepenc. Sipas të dhënave të KEK-ut, në vitin 2013 gjatë procesit të prodhimit të energjisë në këtë korporatë është përdorur rreth 21 milion m<sup>3</sup>. NewCo Feronikeli furnizohet me ujë për procesin teknologjike nga Bivolaku (hidrosistemi Ibër-Lepenc), i cili ndodhet 17 km larg nga fabrika. Sipas të dhënave NewCo Feronikeli, gjatë vitit 2013 janë shfrytëzuar rreth 1.2 milion m<sup>3</sup> ujë. KRU “Mitrovica” shfrytëzon ujë për të furnizuar popullatën në rajonin e Mitrovicës me sasi Q=500 l/s. Aktualisht, është duke u prodhuar energji nga Hidrocentrali i Ujmanit me rreth 35 MW</p>	<p>ZKM dhe Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, sigurojnë bashkëpunimin e nevojshëm për Departamentin e Energjisë në SHBA dhe njësi të tjera të qeverisë së SHBA-ve duke krijuar grupin punues për studimin e fizibilitetit, duke u fokusuar në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përcaktimi i alokimit teknik ekzistues të burimeve ujore të liqenit.</li> <li>• Eksplorimi i mundësive, nëse ka, për të avancuar infrastrukturën e liqenit për të optimizuar furnizimin me ujë, për të mundësuar përdorimin për qëllime të tjera (p.sh. ujitje, ujë të pijshëm).</li> <li>• Sigurimi që secili rekomandim ose propozim në studim nuk duhet të rrezikojë shfrytëzimin ekzistues të ujit</li> </ul>	<p>Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit</p>

8	<p><i>Të dy palët do të diversifikojnë furnizimet e tyre të energjisë.</i></p>	<p>Burimet e furnizimit me energji në Kosovë janë mjaft të kufizuara. Aktualisht, prodhimi i energjisë elektrike, me rreth 95% , është i bazuar në përdorimin e thëngjillit si burim të energjisë. Njësit gjeneruese të energjisë elektrike janë termocentralet: TC Kosova A – Kapacitet i instaluar rreth 800 MË (5 njësi), kurse kapaciteti aktual gjenerues rreth 400 MË (operohet me tre njësi) dhe TC Kosova B – Kapaciteti i instaluar rreth 680 MË (2 njësi me nga 339MË) kurse kapaciteti aktual gjenerues rreth 520 -550 MË. Burimet e ripërtitshme të energjisë , trajtohen si burime të energjisë në Kosovë, dhe kontribuojnë me rreth 5% të totalit të energjisë elektrike. Burimet hidrike/uji me kapacitet të instaluar në total rreth 71 MË; Burimet Solare - me kapacitet të instaluar në total rreth 6.5 MË dhe Burimet nga Era me kapacitet te instaluar ne total rreth 34 MË. Burimet e energjetike të destinuara për prodhimin e energjisë termike, bazohen në: Biomasa – Dru - rreth 1.2 milion m3 përdoret aktualisht ku kryesisht përdoret për ngrohje dhe Ngrohtoret qendrore në operim janë: Ngrohtorja e Prishtinës Termokos -140 MË dhe Ngrohtorja e Gjakovës 15 MË (ende nuk është në operim), si dhe Ngrohtorja e qytetit të Zveçanit dhe Mitrovicës (kapacitete të vjetruara - nuk janë në operim). Për zhvillimin e mëtejme të sektorit të energjisë, së fundi janë realizuar aktivitetet në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Studimi i parafizibilitetit të gaz sjellësit Kosovë – Shqipëri – ALKOGAP – mbështetur nga EBRD; Studimi i parafizibilitetit të gaz në Kosovë – mbështetur nga MCC; Studimi i fizibilitetit për gazsjellësin Kosove – Maqedoni e Veriut, mbështetur nga EBRD – në proces të realizimit dhe Studimi i fizibilitetit për zhvillimin e sistemeve të ngrohjes qendrore në qytetet e mëdha të Kosovës.</li> <li>• USAID është duke realizuar një vlerësim në të gjithë vendin për të identifikuar gatishmërinë e biznesit dhe kufizimet ligjore për të zgjeruar burimet e ripërtitshme.</li> <li>• USAID dhe MCC janë duke punuar me bankat, rregullatorët dhe bizneset për të zhbllokuar pengesat e financimit midis bizneseve të vogla dhe bankave</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Finalizimi i studimit të fizibilitetit të gaz-sjellësit Kosovë–Maqedoni - EBRD, është në implementim e sipër;</li> <li>• Përgatitja e studimit të fizibilitetit të zhvillimin e sektorit të gazit në Kosovë, sipas rekomandimit të studimi i parafizibilitetit të mbështetur nga MCC; që pritet shpejt të lancohet si kërkesës;</li> <li>• Finalizimi i Gas master planit – e cila do të duhet të mbështet nga EBRD dhe tashëm është dërguar në WBIF;</li> <li>• Finalizimi i studimit të fizibilitetit për zhvillimin e sistemeve të ngrohjes qendrore në qytetet e mëdha të Kosovës – e cila do të duhet të mbështet nga EBRD dhe tashëm është dërguar në WBIF;</li> <li>• Lehtësimi i diskutimeve me DFC duke organizuar tryeza të rrumbullakëta të sektorit privat për të avancuar investimet e mundshme në infrastrukturë dhe energji.</li> <li>• Përmirësimi i komunikimit ndërmjet industrisë dhe investitorëve të Kosovës dhe SH.B.A.-së për të nxjerrë në pah mundësitë</li> <li>• Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit (MEA) dhe Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) të propozojnë ndryshimet e nevojshme ligjore për të mundësuar zgjerim të konsiderueshëm të gjeneratorëve vet-konsumues të sektorit privat në burimet e ripërtitshme.</li> <li>• MEA dhe ZRRE duhet të përmirësojnë informimin publik dhe komunikimin me konsumatorët për të promovuar një rolë me të drejtpërdrejt dhe pjesëmarrës të publikut në përgjithësi në zhvillimin e politikave në sektorin e energjisë</li> </ul>	<p>MEA në koordinim edhe me aktorët e tjerë relevant sipas përgjegjësiive institucionale si Qeveria e Kosovës dhe Parlamenti i Kosovës, Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE), Korporata Energjetike e Kosovës(KEK); Operatori i Sistemit të Transmisionit (KOSTT); si dhe Donatorët dhe IFI dhe palëve te tjera te interesit</p>
---	--	---	---	--

		<p>vendore për sisteme të fotovoltike në shkallë të vogël, dhe të zhvillohet një listë më e fuqishme e projekteve të bankueshme të energjisë së ripërtërishme.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• USAID është duke ndihmuar Qeverinë e Kosovës në identifikimin e “Pakove të Ankandit” për fushat me potencial për instalimin e paneleve fotovoltaike (PV) ose burime të tjera të ripërtërishme, siç janë shkollat publike, objektet e kujdesit shëndetësor ose toka të tjera të papërdorshme.</li> <li>• USAID është duke ndihmuar në përmirësimin e kapacitetit të ZRRE-së në lidhje me vendosjen e tarifave që do të lejojë rritjen e investimeve në energjinë e ripërtërishme përmes monitorimit të tregut dhe stimujve të bazuar në treg.</li> <li>• USAID po lehtëson integrimin e tregut të energjisë elektrike të Kosovës me Shqipërinë (siç është marrëveshja APEX) dhe vendet e tjera në rajon dhe Evropën Kontinentale.</li> <li>• Vlerësimi i mundësive të Gazit Natyror të Lengëzuar (LNG) përmes grupeve rajonale të punës të USAID-it që mbulojnë shërbimet dhe rregullatorët për planifikimin e sistemit të gazit natyror dhe rregullat e tregut të BE-së.</li> <li>• USAID është duke mbështetur institucionet energjetike të Kosovës, përfshirë MEA, ZRRE, KOSTT, KEK dhe KEDS, në planifikimin e rrjetit të energjisë elektrike dhe gazit dhe reformat e tregut përmes grupeve rajonale të punës me ndërmarrjet dhe rregullatorët dhe mbështetjen e synuar që synon përmirësimin e qëndrueshmërisë operationale dhe financiare.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• MEA (në mungesë të një Operatori Sistemin e Transmisionit të gazit në Kosovë) duhet të angazhohet në modelimin e rrjetit rajonal të gazit natyror dhe analizimin e skenarëve të zhvillimit të infrastrukturës për rajonin përmes programit të USAID.</li> </ul>	
9	<p><i>Të dy palët do të ndalojnë përdorimin e pajisjeve 5G të furnizuar nga ofrues të dyshimtë në rrjetet e tyre të komunikimit. Kur pajisjet e tilla janë tanimë të pranishme, të dy palët angazhohen për largimin dhe bëjnë përpjekjet e tjera të</i></p>	<p>Në tregun e Kosovës nuk përdoren pajisjet transmetuese të furnizuara nga burime dhe nga ofrues të dyshimtë.</p>	<p>MEA në koordinim me ZKM përgatitë vendimin për masat parandaluese të përdorimit të pajisjeve 5G nga ofruesit e dyshimtë.</p> <p>Qeveria e Kosovës dhe Shtetet e Bashkuara nënshkruajnë një Memorandum të Mirëkuptimit për ndalimin e përdorimit të pajisjeve 5G nga ofrues të dyshimtë në rrjetin e komunikimit të Kosovës.</p>	<p>Ministria e Ekonomisë dhe Mjedisit</p>

	<i>ndërmjetësimet në kohën e duhur.</i>			
10	<i>Të dy palët do të rrisin kontrollimin e pasagjerëve në linjat ajrore, shkëmbimin e informacionit midis tyre dhe brenda kornizës së bashkëpunimit më të gjerë të SHBA-së në Ballkan dhe do të angazhohen për përditësime të teknologjisë për të luftuar aktivitetet e paligjshme duke zbatuar dhe funksionalizuar sistemet e shqyrtimit dhe informacionit të ofruara nga SHBA-të, përfshirë PISCES, APIS, ATS dhe SRTP.</i>	MPB së bashku me SHBA-në kanë shqyrtuar mundësitë për të marrë PISCES (ose ndonjë zgjidhje tjetër teknologjike) për t'i përmbushur standardet ndërkombëtare për luftën kundër terrorizmit, më specifiku, për të përmirësuar skanimin (screening) siç parashihet me Rezolutat e OKB-së 2178 dhe 2396. Më 28.05.2020 është nënshkruar marrëveshja për sigurinë e interkoneksionit ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës dhe Departamentit të Sigurisë Kombëtare të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Shërbimit Amerikan të Doganave dhe Mbrojtjes së Kufirit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e cila parasheh detajet teknike të funksionimit të ATS-G përkatësisht APIS. Më 27.07.2020 Ministri i Punëve të Brendshme ka nënshkruar Udhëzimin administrativ (MPB) nr.02/2020 për masat dhe procedurat e pranimit dhe përdorimit të të dhënave të IPU (API) dhe REU (PNR). Në javën e tretë të muajit Shkurt 2020 Ambasada Amerikane së bashku me ICITAP dhe ekipin nga ShBA, kanë filluar sjelljen e pajisjeve për ATSG, të cilat janë instaluar, konfiguruar dhe të gatshme për testim.	Testimi i komunikimit më ofruesin e të dhënave për API.	Ministria e Punëve të Brendshme
11	<i>Të dy palët zotohen të mbrojnë dhe promovojnë lirinë fetare, duke përfshirë komunikimin ndër fetar, mbrojtjen e vendeve fetare dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore që i përkasin Kishës Ortodokse Serbe dhe rikthimin e vazhdueshëm të pasurisë hebreje të patrashëguar dhe të pa kërkuar që nga periudha e Holokaustit.</i>	Ligji aktual për Lirinë Fetare i vitit 2007 ka mangësi të theksuara ndërsa Ligji i ri i ka kaluar të gjitha fazat e hartimit dhe pritët të miratohet nga Qeveria, më pastaj të dërgohet në Kuvend.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Miratimi i Ligjit të ri për lirinë fetare nga Qeveria dhe Kuvendi.</li> <li>• Krijimi i Grupit nderministror për analizimin e gjendjes aktuale sa i përket pasurisë hebreje të patrashëguar dhe të pa kërkuar që nga periudha e Holokaustit.</li> </ul>	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
12	<i>Të dy palët zotohen të shpejtojnë përpjekjet për të gjetur dhe identifikuar mbetjet e personave të zhdukur. Të dy</i>	<b>Të pagjeturit</b> Aktualisht janë edhe 1640 persona të zhdukur, nga më shumë se 6000 raste të personave të zhdukur që ishin të regjistruara në organizatat ndërkombëtare të angazhuar në	<b>1. Zgjidhja e rasteve të të pagjeturve</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Deri në fund të vitit do të vazhdohet puna, në kuptimin e gërmimit vlerësues edhe në disa lokacione tanimë të</li> </ul>	Zyra e Kryeministrit Ministria për Komunitete dhe Kthim

<p><i>palët angazhohen të identifikojnë dhe zbatojnë zgjidhje afatgjata, të qëndrueshme për refugjatët dhe personat e zhvendosur brenda vendit. Të dy palët angazhohen të identifikojnë një pikë kontakti për të udhëhequr këto përpjekje brenda ministrive të tyre përkatëse qeveritare dhe për të bërë koordinimin mes Beogradit dhe Prishtinës, si dhe do të ofrojnë një përditësim vjetor mbi numrin e çështjeve të zgjidhura dhe në pritje.</i></p>	<p>këtë proces dhe në Komisionin Qeveritar për Persona të Zhdukur. Viteve të fundit, procesi i ndriçimit të fatit të personave të zhdukur (procesi në Kosovë dhe më gjerë) përballet me dy sfida: mungesa e informacioneve të besueshme dhe çështja e mbetjeve mortore të paidentifikuara. Mungesa e informacioneve, ndërlihet me mungesën e bashkëpunimit të mjaftueshëm nga pala serbe, përkundër takimeve të vazhdueshme (qoftë në nivel bilateral, në kuadër të Grupit Punues për Persona të Zhdukur, dhe tani takimet në Bruksel, apo edhe në nivel rajonal në zbatim të 'Planit Kornizë Rajonal në adresimin e çështjes së personave të zhdukur në ish-Jugosllavi').</p> <p><b>Kthimi i personave të zhvendosur</b></p> <p>Në fund të vitit 2014, Ministria për Komunitete dhe Kthim, në bashkëpunim me OSBE-në dhe misionin e UNHCR-it në Kosovë, filluan një iniciativë rajonale dhe ndërinstucionale të njohur si "Procesi i Shkupit" në mënyrë që të gjente zgjidhje të qëndrueshme për personat e zhvendosur nga Kosova. Delegacionet zyrtare qeveritare të Prishtinës - Kosovës, Beogradit - Serbisë, Shkupit - Maqedonisë Veriore dhe Podgoricës - Malit të Zi ranë dakord mbi krijimin e grupeve teknike të punës (1. dokumente personale, 2. siguri, 3. dialog dhe riintegrim, 4. menaxhim të të dhënave, 5. zgjidhje të qëndrueshme dhe 6. të drejta pronësore) dhe iniciimin e të ashtuquajturave forum i nivelit të lartë për të mundësuar bashkëpunimin politik dhe mbështetjen për kthimin dhe procesin e integritetit të personave të zhvendosur nga Kosova. Si rezultat i takimeve të shumta të ekspertëve dhe anëtarëve të grupeve teknike të punës, u miratua Koncept Dokumenti, i cili përfshinte një paketë masash veprimi që duheshin ndërmarrë me qëllim kthimin dhe integrimin efektiv të personave të zhvendosur.</p>	<p>shënjuara brenda territorit të Republikës së Kosovës (diku deri në 5 lokacione, si në Mitrovicë, Pejë, Bishtazhin, Podujevë, Rahovec, megjithatë plani i lokacioneve mund të ndryshojë varësisht nga zhvillimet në rastet e caktuara).</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shqyrtimi i kërkesave nga pala serbe për disa lokacione brenda territorit të Republikës së Kosovës, të cilat janë trajtuar vite më parë nga organizatat/misionet ndërkombëtare.</li> <li>• Shqyrtimi i lokacioneve sipas informatave të siguruar nga arkivat ndërkombëtare përmes Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq.</li> <li>• Kërkesa për palën serbe për iniciimin e gërmimit për një numër lokacionesh, kryesisht në regjionin e Rashkës, si dhe lokacionet të cilat janë hapur në vitet e para të pasluftës.</li> <li>• Kërkesa për qasje në informacion në arkivat e Serbisë, në veçanti në arkivat e ish-Ushtrisë Jugosllave.</li> <li>• Të mbështetet lansimi publik i Bazës së të Dhënave të Personave të Zhdukur Aktivë të lehtësuara nga Komiteti Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP) nga konfliktet e armatosura në territorin e ish-Jugosllavisë</li> <li>• Të ndërmerren veprime për zgjidhjen e rasteve të paidentifikuara (NN – nomen nescio) në morgun e Prishtinës</li> <li>• Sigurimi i burimeve të nevojshme për të vazhduar procesin e futjes së të dhënave (baza e të dhënave Ante Mortem / Post Mortem). Mungesa e progresit për këtë çështje e pengon qeverinë të marrë përgjegjësinë e saj për të krijuar, mirëmbajtur dhe menaxhuar listën e personave të zhdukur, në përputhje me</li> </ul>	
--	---	---	--



			<p>Ligjin për Personat e Zhdukur.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Pjesëmarrja e plotë e Komisionit Qeveritar të Kosovës në Grupin e Personave të Zhdukur, i cili përbëhet nga autoritetet kombëtare përgjegjëse për personat e zhdukur nga Kroacia, Bosnja dhe hercegovina, Mali i Zi, Kosova dhe Serbia.</li> <li>• Të caktohet një hetues / studiues i specializuar i PK-së për çdo rast të iniciuar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore.</li> <li>• Të ngriten kapacitetet për Analizimin e ADN-së në kaudër të Agjencisë së Forensikës së Kosovës përmes blerjes së pajisjeve teknike dhe trajnimeve shtesë dhe sigurimi i qasjes së agjencive të tjera në bazën e të dhënave të ADN-së</li> </ul> <p><b>2. Kthimi i personave të zhvendosur</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Vazhdimi i Iniciativës së Shkupit (ri-analizimi dhe vlerësimi i nevojave të kthimit dhe integritit lokal në Kosovë, Serbi, Mal të Zi dhe Maqedoni Veriore);</li> <li>• Miratimi i propozimeve dhe një plani i zgjidhjeve të qëndrueshme me një afat kohor, si dhe një qasje e përbashkët për marrjen e fondeve (konferenca e donatorëve)</li> <li>• Mbajtja e forumit në një nivel të lartë politik.</li> </ul>	
<b>13</b>	<i>Të dy palët do të punojnë me 69 vende që kriminalizojnë homoseksualitetin, për të nxitur dekriminalizimin.</i>	<p>Në funksion të ngritjes së vetëdijesimit në kuadër të institucioneve dhe publikun të gjerë për të drejtat e komunitetit (LGBT), Qeveria e Republikës së Kosovës ka ndërmarr masa në vazhdimësi që promovojnë dhe mbrojnë të drejtat e komunitetit LGBT.</p> <p>Si rrjedhojë tashmë është krijuar një traditë në vend në shënimin e 17 majit Ditës Ndërkombëtare kundër Homofobisë dhe Transfobisë (IDAHOT). Çdo vit shënohet ceremonia e hapjes së Javës së Krenarisë/Paradës së Krenarisë.</p>	<p>Lobimi përmes ambasadave të Kosovës në 69 vendet që e kanë njohur Kosovën dhe të cilat e kanë të kriminalizuar homoseksualitetin, për të dekriminalizuar atë.</p>	<p>Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës</p>

14	<i>Të dy palët zotohen të përcaktojnë Hezbollahun në tërësinë e saj si organizatë terroriste dhe të zbatojnë plotësisht masat për të kufizuar operacionet dhe aktivitetet financiare të Hezbollahut në juridiksionet e tyre.</i>	Vendimi ku Organizata Globale Terroriste Hezbollah krahu i saj politik dhe ushtarak është shpall Organizatë terroriste, është marrë nga Qeveria me 23/6/2020, nr.03/08.	Të analizohet dhe zhvillohet korniza ligjore për të përcaktuar Hezbollahun si organizatë terroriste në tërësinë e saj, përfshirë masat ligjore për të kufizuar operacionet dhe aktivitetet financiare brenda Kosovës.	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës
15	<i>Kosova do të pranojë të zbatojë një moratorium një vjeçar që pauzon kërkimin për anëtarësim në Organizatat Ndërkombëtare. Serbia do të bëjë një moratorium një vjeçar për ndalje të fushatës së saj të çnjohjes dhe do të përmbahet të kërkojë nga ndonjë shtet ose organizatë ndërkombëtare që të mos njohë Kosovën si një shtet të pavarur. Të dy marrëveshjet për të hequr dorë do të hyjnë në fuqi menjëherë.</i>	<p>Iniciativat në lidhje me anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare përfshijnë kulturën (EUROIMAGES), Tregtinë (EFTA), shëndetësinë dhe sektorë të tjerë.</p> <p>Duhet të definohet se çfarë nënkupton saktësisht kjo, duke përfshirë qartësimin rreth nismave rajonale dhe ato që lidhen me procesin e anëtarësimit në BE.</p>	Lëshohet qarkorja nga MPJD për të gjitha institucionet, ku kërkohet të tërhiqen të gjitha aplikimet dhe ku theksohet se për një periudhë 1 vjeçare, Kosova nuk do të aplikojë në organizata ndërkombëtare.	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës
16	<i>Kosova dhe Izraeli pajtohen të njohin njëra-tjetrën.</i>		Të ndërmeren hapat e nevojshem ligjor për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Izraelin	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës